



Kosovo Property Claims Commission
Komisioni i Kërkesave Pronësore të Kosovës
Komisija Kosovske Agencije za Imovinu

Perandori Justinian 5
Pristina
Tel: +381 (0) 38 249-918
Fax: +381 (0) 38 249-919
E-mail: mailbox@kpaonline.org

VENDIM

PANELI NR: 1

NR I VENDIMIT.: KPCC/D/A/171/2012
DATA E VENDIMIT: 24/10/2012

Komisionerët Heiskanen (Kryetar),
Vokshi dhe Wühler

URDHËR

(1) Në secilën prej 14 (katërmëdhjetë) kërkesave të identifikuara në pjesët A dhe B të listës së bashkëngjitur, Komisioni

vendos që

Paraqitësi i kërkesës ose mbajtësi i së drejtës pronësore, sipas rastit, ka vërtetuar pronësinë për pronën e kërkuar, ose për atë pjesë të saj, ashtu si përcaktohet në vendimin individual përkatës;

(2) Në secilën prej 14 (katërmëdhjetë) kërkesave të referuara në paragrafin (1) më sipër, me përjashtim të kërkesave nr. 15128, 30580, 34497 dhe 44424, Komisioni

urdhëron që

(a) Paraqitësit të kërkesës apo bartësit e së drejtës pronësore, sipas rastit, t'i jepet posedimi i pronës së kërkuar;

(b) Pala përgjegjëse dhe çdo person tjetër i cili ka uzurpuar pronën në mënyrë të paligjshme, ta lirojë atë brenda 30 (tridhjetë) ditësh nga dita e pranimit të këtij urdhri; dhe

(c) Nëse pala përgjegjëse apo çdo person tjetër që ka uzurpuar pronën në mënyrë të paligjshme, i cili dështon të përmbushë urdhrin për lirimin e pronës brenda kohës së dhënë, të dëbohet nga prona.

(3) Në secilën kërkesë të përmendur në kolonat përkatëse në pjesët A dhe B të listës së bashkëngjitur, Komisioni më tutje vendos që kërkesat të hidhen poshtë kur paraqitësit e kërkesave kërkojnë kompensim për dëmin material apo për humbjen e shfrytëzimit të pronës së kërkuar; dhe

- (4) *Më rastet kur ka më shumë se një pronar urdhrat dhe vendimet e mësipërme nuk ndikojnë në të drejtat e bashkëpronarëve respektive.*

KORNIZA LIGJORE

1. Më 13 qershor 2008, në Kosovë ka hyrë në fuqi Ligji nr. 03/L-079 duke plotësuar dhe ndryshuar Rregulloren e UNMIK-ut 2006/50 mbi zgjidhjen e kërkesave që kanë të bëjnë me pronën e paluajtshme private, përfshirë pronën bujqësore dhe komerciale. Ligji përmban një aneks ("Aneksi I") i cili plotëson dhe ndryshon Urdhëresën Administrative të UNMIK-ut nr. 2007/5, e cila zbaton Rregulloren e UNMIK-ut 2006/50. Me Ligjin nr. 03/L-079 dhe Aneksin i themelohet Agjencia Kosovare e Pronës ("AKP") si agjenci e pavarur, dhe ndryshohen dispozitat përkatëse të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 dhe Urdhëresës Administrative të UNMIK-ut 2007/5 si të domosdoshme për të zbatuar ndryshimet në kornizën e aplikueshme ligjore. Në pajtueshmëri me dispozitat e tyre, Ligji nr. 03/L-079 dhe Aneksi i kanë hyrë në fuqi me publikimin e tyre në Gazetën Zyrtare.

2. Sipas nenit 22 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, Rregullorja pushoi së aplikuari me datën 31 dhjetor 2008. Prandaj, Ligji nr. 03/L-079 është aktualisht burimi i vetëm i autoritetit ligjor të Komisionit. Dispozitat e Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 vazhdojnë të mbesin relevante vetëm ashtu siç janë inkorporuar sipas Ligjit nr. 03/L-079.

ARSYET PËR VENDIM

3. Paraqitësi i kërkesës apo bartësi i së drejtës pronësore, siç mund të jetë rasti, ka të drejtë në urdhër nga Komisioni për riposedit të pronës, nëse paraqitësi i kërkesës dëshmon:

- (a) pronësinë mbi pronën e paluajtshme private, përfshirë pronën bujqësore dhe komerciale; ose
- (b) të drejtën e shfrytëzimit në lidhje me pronën e paluajtshme private, përfshirë pronën bujqësore dhe komerciale,

ku paraqitësi i kërkesës apo bartësi i së drejtës pronësore, siç mund të jetë rasti, tani nuk mund të ushtrojë të drejta të tilla pronësore, dhe ku kërkesa përfshin rrethanat e ndërlydhura drejtpërsëdrejti me, apo që janë pasojë e konfliktit të armatosur që ka ndodhur në Kosovë mes 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999. (Shih nenin 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 i plotësuar me Ligjin Nr. 03/L-079.)

4. Kur paraqitësi i kërkesës paraqet kërkesë për pronësi në bazë të nenit 3.1(a) të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e miratuar me Ligjin nr. 03/L-079, Komisioni duhet ta zgjidhë çështjen e pronësisë dhe, nëse Komisionit i është dëshmuar pronësia dhe paraqitësi i kërkesës nuk e dëshmon të kundërtën, të jap urdhër për riposedit në dobi të paraqitësit të kërkesës apo bartësit të së drejtës pronësore, siç mund të jetë rasti. Kur paraqitësi i kërkesës paraqet kërkesë për të drejtën e shfrytëzimit të pronës në pajtim me nenin 3.1(b) të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të plotësuar me Ligjin Nr. 03/L-079, Komisioni mund të shqyrtojë kërkesën me procedurë përmbledhëse dhe të lëshojë urdhër për kthimin e posedimit. (Shih nenin 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, lexo bashkë me nenin 9 të Aneksit III të Urdhëresës Administrative nr. 2007/5 të plotësuar me Ligjin Nr. 03/L-079.)¹

¹ Duket se ka një gabim teknik në Aneksin I. Ndonëse në mënyrë të qartë paraqitet që Aneksi i kishte për qëllim të zëvendësonte në tërësi Urdhëresën Administrative të UNMIK-ut 2007/5, përfshirë që të tri Anekset e saj, Neni 26 i Aneksit i parasheh që e drejta nga Aneksi III i Urdhëresës Administrative të UNMIK-ut 2007/5 duhet të

5. Komisioni mbajti seancën e tridhjetenjë nga 22 deri 24 tetor 2012 në Prishtinë. Komisionit i janë paraqitur gjithsej 753 kërkesa për pronë bujqësore në seancën e tridhjetenjë nga Sekretaria Ekzekutive e KPA-së (“Sekretaria Ekzekutive”), së bashku me dokumentacionin mbështetës, raportet e përpunimit të kërkesave, raportet e verifikimit, memorandumet ligjore dhe informata të tjera relevante. Dy kërkesa për pronë bujqësore të cilat iu paraqitën Komisionit u kthyen Sekretarisë Ekzekutive nga Komisioni gjatë seancës dhe gjashtë kërkesa për pronë bujqësore të cilat i ishin paraqitur Komisionit u tërhoqën nga Sekretaria Ekzekutive gjatë seancës. Komisioni ndërpreu shqyrtimin e një kërkesë për pronë bujqësore në pritje të mbajtjes të seancës dëgjimore. Përveç kësaj, Komisioni vendosi katër kërkesa të cilat ishin pezulluar më parë në pritje të mbajtjes së seancës dëgjimore. Gjithsej 748 kërkesa për pronë bujqësore u vendosën nga Komisioni gjatë seancës.

6. Në seancën e Komisionit, Sekretaria Ekzekutive i ka prezantuar kërkesat Komisionit dhe ka raportuar për përpunimin e kërkesave dhe çështjet ligjore dhe dëshmuese të cilat kanë rrjedhur nga kërkesat. Më kërkesë të Komisionit, Sekretaria Ekzekutive ka ofruar informata dhe sqarime shtesë, sipas nevojës.

A. Kërkesa të përfshira në këtë vendim

7. Në të gjitha kërkesat e përfshira në këtë vendim paraqitësit e kërkesave kërkojnë zgjidhjen e kërkesës pronësore. Të gjitha kërkesat kanë të bëjnë me pronat bujqësore, përfshirë arat, kullotat dhe pyjet.

8. Ky vendim zbatohet për katërmbëdhjetë kërkesa të identifikuar në listën e bashkangjitur. Nga këto kërkesa, kërkesat nr. 15128, 30580, 45218 dhe 45222 kanë qenë subjekt i një vendimi² të mëparshëm të Komisionit. Megjithatë, vendimet e mëparshme në këto kërkesa janë shfuqizuar nga Komisioni për shkak të notifikimit të pasaktë të pronave të kërkuara gjatë përpunimit të kërkesave nga Sekretaria Ekzekutive ose për shkak të gabimeve të përpunimit nga Sekretaria Ekzekutive të cilat janë identifikuar pasi është marrë vendimi. Për rrjedhojë, këto kërkesa duhet të rivendosen pas notifikimit të saktë të pronës së kërkuar. Sekretaria Ekzekutive i ka shkruar paraqitësit të kërkesës duke e informuar ata për gabimet e notifikimit dhe i ka informuar se kërkesa do të rivendoset pas notifikimit të saktë të pronës të kërkuar. Paraqitësit e kërkesës si dhe autoritetet e kadastrave përkatëse janë informuar se vendimet e mëparshme të Komisionit janë pavlerë dhe nuk mund të përdoren për qëllimet e çfarëdo transaksioni ligjor. Pjesa e mbetur prej 734 kërkesave për pronë bujqësore të trajtuara nga Komisioni gjatë seancës përfshihen në dy vendimet e tjera KPCC/D/A/170/2012 dhe vendimin KPCC/D/A/172/2012.

9. Të katërmbëdhjetë kërkesat e përfshira në këtë vendim janë kontestuese në kuptimin se pala që ka uzurpuar pronat e kërkuara ose pala që ka shprehur interes ligjor në këto prona (“pala përgjegjëse”) e ka kontestuar vlefshmërinë e kërkesës brenda afatit 30 ditor të përcaktuar me nenin 10.2 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e miratuar me Ligjin nr. 03/L-

zëvendësohet me të drejtën e cila referohet në Aneksin II. Megjithatë, nuk ka ndonjë dispozitë të veçantë apo ndonjë të dhënë tjetër në Ligjin 03/L-079 apo në Aneksin e tij që qëllimi i këtij ndryshimi të veçantë ishte të heqë Aneksin I apo Aneksin II të Urdhërësës Administrative të UNMIK-ut. Rrjedhimisht, Komisioni konsideron që të tri Aneksin e Urdhërësës Administrative të UNMIK-ut 2007/5 janë përfshirë në pakon legjislative dhe Komisioni do t’u referohet në këtë vendim si Nën-Aneksin I, II dhe III, respektivisht.

² Kërkesa nr. 15128 është vendosur me KPCC/D/A/29/2008 datë 19 dhjetor 2008, Kërkesa nr. 30580 është vendosur me KPCC/D/A/13/2008 datë 13 prill 2008, Kërkesa nr. 45218 është vendosur me KPCC/D/A/36/2009 datë 23 prill 2009, Kërkesa nr. 45222 është vendosur me KPCC/D/A/42/2009 datë 11 qershor 2009.

079, ose në një fazë të mëvonshme gjatë procedurës në pajtim me nenin 10.3 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e miratuar me Ligjin nr. 03/L-079.

10. Me qëllim që të përmbushen kushtet e një kërkesë të vlefshme, paraqitësi i kërkesës ose bartësi i së drejtës pronësore, sipas rastit, duhet të tregojë se ai ka pasur të drejtë pronësore në lidhje me pronën e kërkuar dhe se ai ose ajo nuk ka mundësi të ushtrojë të drejtën pronësore për shkak të rrethanave që lidhen drejtpërdrejtë ose rezultojnë nga konflikti i armatosur që ndodhi në Kosovë midis 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999.

1. Kërkesa kontestuese – mbrojtje e thjeshtë

11. Në tri kërkesat e identifikuar në pjesën A të listës së bashkangjitur, pala që ka uzurpuar pronën e kërkuar ose pala që ka shprehur interes ligjor në këtë pronë (“Pala përgjegjëse”) ose nuk ka paraqitur mbrojtje të vlefshme në përgjigje të kërkesës ose thjesht ka kërkuar të ketë lejen e paraqitësit të kërkesës për të shfrytëzuar pronën pa ofruar ndonjë dëshmi në mbështetje të pretendimeve. Në mungesë të mbrojtjes së vlefshme nga palët përgjegjëse, Komisioni konstaton se kërkesat duhet të miratohen.

a. Në kërkesën nr. 24189

12. Kërkesa nr. 24189, është depozituar fillimisht nga paraqitësi i kërkesës në cilësinë e anëtarit të bashkësisë familjare të mbajtësit të pretenduar të së drejtës pronësore, pikërisht nënës së saj të ndjerë, Cvija Dutina. Megjithatë, në vitin 2008, pas depozitimit të kërkesës, prona e kërkuar është transferuar tek Dragana Filipovic, mbesa e Cvija Dutina, mbi bazën e vendimit të trashëgimisë. Më pas, Dragana Filipovic e pajisi paraqitësin e kërkesës me autorizim për të proceduar kërkesën para AKP-së në emrin e saj si mbajtëse me të drejta të plota e së drejtës pronësore.

13. Në mbështetje të kërkesës, paraqitësi i kërkesës paraqiti vendimin e trashëgimisë të vitit 2008 në bazë të të cilit Dragana Filipovic e ka trashëguar pronën e kërkuar. Pronësia e Dragana Filipovic është konfirmuar gjithashtu me anë të certifikatës për të drejtat e pronës së paluajtshme të vitit 2012, e cila është gjetur *ex officio* nga Sekretaria Ekzekutive.

14. Pala përgjegjëse, që ka uzurpuar aktualisht pronën e kërkuar, pretendon se ka të drejtë ligjore për pronën, megjithatë, ka dështuar të ofrojë dëshmi në mbështetje të pretendimit.

15. Bazuar në dëshmitë para tij dhe në mungesë të mbrojtjes së vlefshme nga pala përgjegjëse, Komisioni konstaton se kërkesa duhet të miratohet në emër të Dragana Filipovic.

b. Kërkesa nr. 29072

16. Kërkesa nr. 29072 është depozituar nga paraqitësi i kërkesës në cilësinë e anëtarit të bashkësisë familjare të mbajtësit të së drejtës pronësore, pikërisht gjyshit të saj të ndjerë. Në mbështetje të kërkesës, paraqitësi i kërkesës ka paraqitur fletën poseduese të vitit 2001, e cila e tregon mbajtësin e pretenduar të së drejtës pronësore si pronar të pronës së kërkuar. Fleta poseduese është verifikuar si e vërtetë nga Sekretaria Ekzekutive.

17. Palët përgjegjëse pretendojnë se ata po e shfrytëzojnë pronën e kërkuar që nga viti 1996 bazuar në një lejë të familjes së paraqitësit të kërkesës për të kultivuar tokën. Megjithatë, palët përgjegjëse nuk kanë paraqitur asnjë dëshmi në mbështetje të pretendimit të tyre.

18. Bazuar në dëshmitë para tij dhe në mungesë të mbrojtjes së vlefshme nga pala përgjegjëse, Komisioni konstaton se kërkesa duhet të miratohet.

c. Kërkesat nr. 30580 dhe 44424

19. Kërkesat nr. 30580 dhe 44424 janë depozituar nga paraqitësit e kërkesave, dy vëllezër, për të njëjtën pronë, në cilësinë e anëtarit të bashkësisë familjare të mbajtësit të së drejtës pronësore, pikërisht babait të tyre të ndjerë. Ata kërkojnë konfirmimin e bashkëpronësisë për pronën e kërkuar, parcelën nr. 237. Fillimisht, paraqitësit e kërkesës depozituan kërkesë për parcelën nr. 544 në vend të parcelës nr. 237, por më pas shpjeguan se dy parcelat kanë qenë objekt i një kontrate informale shkëmbimi në vitin 1993, mes babait të tyre si pronar fillestar i parcelës nr. 544, dhe palës së tretë Zeqir Ooti, si pronar fillestar i parcelës nr. 237. Bazuar në kontratën e shkëmbimit, babai i paraqitësit të kërkesës u bë pronar i parcelës nr. 237. Në mbështetje të pretendimit të tyre, paraqitësit e kërkesave kanë paraqitur kontratën joformale të shkëmbimit të vitit 1993. Kur u kontaktua nga Sekretaria Ekzekutive, pala e tretë Zeqir Ooti konfirmoi se shkëmbimi ishte bërë në vitin 1993.

20. Kur u notifikua parcela nr. 544 që u kërkuar fillimisht, pala përgjegjëse e kërkoj të drejta ligjore për këtë parcelë duke deklaruar se e kishte blerë parcelën e kërkuar nga pala e tretë Zeqir Ooti. Megjithatë, nuk u kërkuar nga pala përgjegjëse asnjë ë drejtë ligjore për parcelën nr. 237.

21. Bazuar në dëshmitë para tij, Komisioni konstaton se babai i ndjerë i paraqitësve të kërkesës është mbajtësi i së drejtës pronësore për parcelën e kërkuar nr. 237. Rrjedhimisht kërkesat nr. 30580 dhe 44424 duhet të miratohen.

2. Kërkesa kontestuese – të tjera

22. Në njëmbëdhjetë kërkesat e identifikuar në pjesën B të listës së bashkangjitur, pala apo palët që kanë uzurpuar pronat e kërkuara, ose pala që ka shprehur interes ligjor në këto prona (“pala përgjegjëse”) e ka kundërshtuar vlefshmërinë e kërkesës, megjithatë Komisioni ka arritur në përfundimin se kërkesat duhet të miratohen për arsyt e përmendura më poshtë.

a. Kërkesa nr. 00744

23. Kërkesa nr. 00744 është depozituar nga paraqitësi i kërkesës në cilësinë e anëtarit të bashkësisë familjare të mbajtësit të së drejtës pronësore, pikërisht babait të saj. Në mbështetje të kërkesës, paraqitësi i kërkesës paraqiti lloje të ndryshme dokumentesh përfshirë certifikatën për të drejtat e pronës së paluajtshme të vitit 2008. Kjo certifikate është verifikuar si e vërtetë nga Sekretaria Ekzekutive, ajo e tregon mbajtësin e së drejtës pronësore si pronar të pronës së kërkuar.

24. Pala përgjegjëse, që ka uzurpuar aktualisht pronën e kërkuar, pretendon se familja e tij e ka blerë atë nga një palë e tretë në fund të viteve 1980. Megjithatë, pala përgjegjëse ka dështuar të ofrojë dëshmi në mbështetje të pretendimeve.

25. Bazuar në dëshmitë para tij dhe në mungesë të mbrojtjes së vlefshme nga pala përgjegjëse, Komisioni konstaton se kërkesa duhet të miratohet.

b. Kërkesa nr. 15128

26. Kërkesa nr. 15128 është depozituar nga paraqitësi i kërkesës në cilësinë e mbajtësit të së drejtës pronësore. Paraqitësi i kërkesës kërkon konfirmimin e bashkëpronësisë për pronën e

kërkuar dhe riposedimin. Në mbështetje të kërkesës, paraqitësi i kërkesës ka paraqitur dokumente të panumërta duke përfshirë vendimin e trashëgimisë të vitit 1996 dhe fletën poseduese të vitit 1997, që të dyja e tregojnë paraqitësin e kërkesës si bashkëpronar të pronës së kërkuar. Të dy dokumentet janë verifikuar si të vërteta nga Sekretaria Ekzekutive.

27. Pala përgjegjëse, i cili është kunati i paraqitësit të kërkesës dhe bashkëpronar i pronës së kërkuar në bazë të fletës poseduese të vitit 1997, pretendon të jetë pronar i vetëm i pronës së kërkuar. Megjithatë ai nuk i ka provuar pretendimet me dëshmi.

28. Bazuar në dëshmitë para tij dhe në mungesë të mbrojtjes së vlefshme nga pala përgjegjëse, Komisioni konstaton se kërkesa duhet të miratohet.

c. Kërkesa nr. 33737

29. Kërkesa nr. 33737 është depozituar nga paraqitësi i kërkesës (“Paraqitësi i parë i kërkesës”) në cilësinë e anëtarit të bashkësisë familjare të mbajtësit të së drejtës pronësore, pikërisht babait të saj të ndjerë. Paraqitësi i parë i kërkesës kërkon konfirmimin e se drejtës pronësore të vetme të babait të saj për pronën e kërkuar. Në kërkesën e ndërlidhur nr. 29158, kushëriri i paraqitësit të parë të kërkesës, (“Paraqitësi i dytë i kërkesës”) kërkon gjithashtu të drejtën e vetme për pronën e kërkuar.

30. Në mbështetje të kërkesës, paraqitësi i parë i kërkesës, paraqiti *inter alia* marrëveshjen gjyqësore të vitit 1997 mes mbajtësit të pretenduar të së drejtës pronësore dhe paraqitësit të dytë të kërkesës. Sipas dokumentit, është arritur një marrëveshje për pronësinë e vetme të mbajtësit të pretenduar të së drejtës pronësore, babait të ndjerë të paraqitësit të parë të kërkesës, për pronën e kërkuar, në bazë të ndarjes paraprake fizike të pronës. Marrëveshja është verifikuar si e vërtetë nga Sekretaria Ekzekutive.

31. Sekretaria Ekzekutive ka gjetur *ex officio* vendimin e trashëgimisë të vitit 1995 në bazë të të cilit mbajtësi i pretenduar i së drejtës pronësore ka trashëguar pronën e kërkuar si bashkëpronar së bashku me paraqitësin e dytë të kërkesës.

32. Bazuar në dëshmitë para tij, Komisioni konstaton se paraqitësi i parë i kërkesës ka vërtetuar të drejtën e vetme pronësore të babait të saj për pronën e kërkuar. Rrjedhimisht kërkesa duhet të miratohet në emër të tij.

d. Kërkesa nr. 34497

33. Kërkesa nr. 34497 është paraqitur nga paraqitësi i kërkesës në cilësinë e anëtarit të bashkësisë familjare të mbajtësit të pretenduar të së drejtës pronësore, pikërisht babait të saj. Paraqitësi i kërkesës ka paraqitur fletën poseduese të vitit 2010 në emër të mbajtësit të pretenduar të së drejtës pronësore. Me tej, paraqitësi i kërkesës ka paraqitur një certifikatë vdekje në bazë të secilës mbajtësi i së drejtës pronësore ka ndërruar jetë më 1980. Të dy dokumentet janë verifikuar si të vërteta nga Sekretaria Ekzekutive. Paraqitësi i kërkesës pretendon se vëllezërit e saj Martin dhe Nikola e kanë shitur pronën e kërkuar pa dijeninë e saj dhe motrës së saj. Ajo i kërkon AKP-së të ndërmjetësojë mes saj dhe vëllezërve të saj duke pranuar se nuk ka filluar procedure trashëgimie.

34. Pala përgjegjëse pohon se e ka blerë pronën e kërkuar në vitin 2001. Në mbështetje të pohimit, pala përgjegjëse ka paraqitur kontratën e blerjes të vitit 2001 të lidhur mes palës së tretë, Ilmi Rrahmani, në cilësinë e shitësit në emër të mbajtësit të së drejtës pronësore gjoja i autorizuar nga ai, dhe palës përgjegjëse në cilësinë e blerësit. Sekretaria Ekzekutive e ka verifikuar si të vërtetë kontratën e blerjes. Në bazë të kësaj kontrate të blerjes, janë përditësuar

regjistrat kadastrale në emër të palës përgjegjëse e dëshmuar kjo me certifikatën për të drejtat e pronës së paluajtshme të vitit 2012. Pala përgjegjëse, ka paraqitur gjithashtu një autorizim të vitit 2001 ku pretendohet se autorizohet Ilmi Rrahmani për të shitur pronën e kërkuar dhe për të nënshkruar kontratën e blerjes. Autorizimi është vërtetuar me vulën e noterit të ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë por vërtetësia e saj nuk ka mundur të verifikohet nga Sekretaria Ekzekutive.

35. Paraqitësi i kërkesës pretendon se autorizimi i paraqitur nga pala përgjegjëse është falsifikuar nga vëllezërit e sa, gjë për të cilin ajo ka depozituar padi në gjykatën kompetente. Pala përgjegjëse nuk bashkëpunoi më tej në shpjegimin e rrethanave të sakta të transaksionit.

36. Komisioni arrin në përfundimin se ai nuk mund të mbështetet në autorizimin e paraqitur nga pala përgjegjëse. Autorizimi pretendohet të jetë lëshuar nga mbajtësi i së drejtës pronësore në vitin 2001, megjithatë, Komisioni vëren se ky i fundit kishte vdekur tashmë në vitin 1980. Rrjedhimisht, Ilmi Rrahmani nuk ka pasur kompetenca të shesë pronën e kërkuar dhe pala përgjegjëse nuk ka mundur të përfitojë pronësinë për pronën përmes kontratës të bazuar në autorizimin e pavlefshëm.

37. Bazuar në dëshmitë para tij, Komisioni konstaton se kërkesa duhet të miratohet në emër të mbajtësit të së drejtës pronësore.

e. Kërkesat nr. 45218, 45220, 45221 dhe 45222

38. Kërkesat nr. 45218, 45220, 45221 dhe 45222 janë depozituar nga paraqitësi i kërkesës në cilësinë e mbajtësit të së drejtës pronësore. Paraqitësi i kërkesës kërkon konfirmimin e bashkëpronësisë dhe riposëdimin për pronat e kërkuara. Në mbështetje të kërkesave, paraqitësi i kërkesës ka paraqitur *inter alia* vendimin e verifikuar pozitivisht të trashëgimisë të vitit 1985, sipas secilit paraqitësi i kërkesës ka trashëguar pronat e kërkuara në bashkëpronësi me gjyshin e tij.

39. Pala përgjegjëse e kundërshton kërkesën duke pohuar se pronat e kërkuara janë në bashkëpronësi me katër palë të treta si edhe me vetë palën përgjegjëse bazuar në posedimin e pandërprerë për më tepër se 40 vjet duke deklaruar se familja e tij ka ndërtuar shtëpi banimi në pronën e kërkuar pasi gjyshi i paraqitësit të kërkesës, ashtu si pretendohet, i ka transferuar pjesë të tokës tek familja e palës përgjegjëse. Megjithatë, pala përgjegjëse dështoi të paraqitë dëshmi në mbështetje të këtyre pretendimeve.

40. Bazuar në dëshmitë para tij, Komisioni konstaton se paraqitësi i kërkesës ka dëshmuar bashkëpronësinë për pronat e kërkuara. Rrjedhimisht kërkesat duhet të miratohen.

f. Kërkesa nr. 48148 dhe 48149

41. Kërkesat nr. 48148 dhe 48149 janë depozituar nga paraqitësi i kërkesës në cilësinë e mbajtësit të së drejtës pronësore. Në mbështetje të kërkesave, paraqitësi i kërkesës ka paraqitur certifikatën për të drejtat e pronës së paluajtshme të vitit 2008, që e tregon atë si pronar i pronave të kërkuara. Kjo certifikatë është verifikuar si e vërtetë nga Sekretaria Ekzekutive.

42. Pala përgjegjëse, i cili ka qenë fqinjë i paraqitësit të kërkesës para konfliktit dhe i cili ka uzurpuar tani pronat e kërkuara, pretendon se i ka blerë pronat e kërkuara nga paraqitësi i kërkesës para konfliktit. Megjithatë, ai dështoi të mbështesë pretendimet e tij me prova.

43. Bazuar në dëshmitë para tij, dhe në mungesë të mbrojtjes së vlefshme nga pala përgjegjëse, Komisioni konstaton se paraqitësi i kërkesës ka dëshmuar se është pronar i pronave të kërkuara. Rrjedhimisht kërkesat duhet të miratohen.

44. Nga sa u tha më sipër, bazuar në dëshmitë që i posedon, Komisioni konstaton se në kërkesat e identifikuar ne pjesët A dhe B të listës së bashkangjitur:

- (a) paraqitësi i kërkesës apo bartësi i së drejtës pronësore, siç mund të jetë rasti, ka të drejtën e pronësisë në lidhje me pronën e kërkuar, apo pjesën e tillë siç është specifikuar në vendimin përkatës individual;
- (b) paraqitësi i kërkesës apo bartësi i së drejtës pronësore, siç mund të jetë rasti, në secilin rast tani nuk mund të ushtrojë të drejtën e tij apo të saj të pronësisë; dhe
- (c) kërkesa në secilin rast përfshinë rrethanat e ndërlidhura drejtpërsëdrejti apo që janë pasojë e konfliktit të armatosur që ka ndodhur mes 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999.

45. Rrjedhimisht, pasi paraqitësit e kërkesave në secilën nga kërkesat e identifikuar në pjesët A dhe B të listës së bashkangjitur kanë dëshmuar të drejtën pronësore për pronën e kërkuar dhe në mungesë të mbrojtjes së vlefshme nga ana e palës përgjegjëse të gjitha këto kërkesa duhet të miratohen.

46. Në kërkesat nr. 15128, 30580 dhe 44424, të referuara në kolonat përkatëse të listës së bashkangjitur, uzurpuesi aktual i pronës së kërkuar është *prima facie* bashkëpronar me të drejta të plota i pronave të kërkuara. Në kërkesën nr. 34497, paraqitësi i kërkesës deklaroi se ai nuk kërkon riposelimin. Në këto rrethana, duhet të miratohet urdhër për konfirmimin e së drejtës pronësore në dobi të paraqitësit të kërkesës, sipas rastit, pa urdhër dëbimi apo ndonjë formë të mjetit ligjor ndihmës, ashtu si përcaktohet më sipër.

3. Kërkesa për kompensim

47. Komisioni vëren se në disa nga kërkesat të përfshira në këtë vendim, paraqitësit e kërkesave gjithashtu kërkojnë, përveç pronësisë, kompensimin për dëmin material apo humbje të shfrytëzimit, të pronës së kërkuar. Sipas Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 miratuar me Ligjin Nr. 03/L-079, Komisioni nuk ka juridiksion për kërkesat e tilla. Rrjedhimisht, këto kërkesa duhet të hidhen poshtë.

B. Vërejtje përmbledhëse

48. Vendimi dhe urdhri i Komisionit gjithashtu aplikohen, ku është e përshtatshme, edhe për çdo pronë të bashkuar, d.m.th. për çdo tokë apo ndërtesë të zotëruar apo të shfrytëzuar nga paraqitësi i kërkesës ose bartësi i së drejtës pronësore, sipas rastit, të cilat formojnë një njësi me pronën e kërkuar.

49. Neni 8.8 i Aneksit III të Urdhërësës Administrative të UNMIK-ut nr. 2007/5 të miratuar me Ligjin 03/L-079 lejon Kryetarin e Komisionit të nënshkruajë vendimin grupor duke aprovuar të gjitha kërkesat individuale të identifikuar në vendimin grupor, nëse numri i kërkesave të vendosura gjatë seancës është i lartë. Komisioni konsideron se kjo aplikohet në rastin konkret.

50. Vendimi i Komisionit nuk paragjykon të drejtën e paraqitësve të kërkesës ose mbajtësve të së drejtës pronësore sipas rastit, për të kërkuar konfirmimin e te drejtave të tyre pronësore për pronat e kërkuara para autoriteteve kompetente vendore të tilla si autoritetet kadastrale apo gjykatat vendore, në përputhje me ligjin në fuqi.



Kryetari

ANKESAT

Rregullorja e UNMIK-ut 2006/50 dhe Ligji Nr. 03/L-079 parashohin që:

12.1 Brenda 30 (tridhjetë) ditësh nga njoftimi i palëve nga Agjencia Kosovare e Pronës për vendimin e Komisionit mbi kërkesën, pala mund të paraqesë ankesë ndaj vendimit të tillë në Gjykatën Supreme të Kosovës përmes Sekretarisë Ekzekutive të Agjencisë Kosovare të Pronës.

12.3 Ankesa mund të paraqitet duke u bazuar në atë se:

- (a) Vendimi përmban gabim thelbësor apo moszbatim serioz të ligjit material apo procedural; apo
- (b) Vendimi mbështetet në vlerësim të gabuar apo të mangët të fakteve.

Gjykata Supreme mund të vjelë tarifat për procedurën e ankesës.

Informacione lidhur me procedurën e ankesave gjenden në fletën informuese për ankesën e cila u ofrohet palëve së bashku me vendimin.

*** Versioni në gjuhën angleze është versioni zyrtar i të gjitha vendimeve të Komisionit për Kërkesa Pronësore. Në rast të mospërputhjes mes versionit në gjuhën angleze dhe versionit në gjuhën shqipe apo serbe, atëherë mbizotëron versioni në gjuhën angleze**

Spreadsheet /Lista /Prilog

Part A/Pjesa A/Deo A

KPA24189
KPA29072

Spreadsheet /Lista /Prilog

Part B/Pjesa B/Deo B

KPA15128 REP	KPA30580 REP	KPA33737	KPA34497	KPA44424	KPA48148	KPA48149
KPA00744	KPA45218	KPA45220	KPA45221	KPA45222		